# LC WAIKIKI Retail AL Sh.p.k
# (Ish Tema Retail Al Shpk)

Pasqyrat Financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014

PERMBAJTJA:


| | | |
|---|---|---|
| PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE | | 1 |
| PASQYRA E TE ARDHURAVE | | 2 |
| PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE | | 3 |
| PASQYRA E LEVIZJEVE NE KAPITAL | | 4 |
| 1. | Informacion i pergjithshem | 5 |
| 2. | Permbledhje e politikave te rendesishme kontabile | 5 |
| 3. | Aktivet afatgjate materiale | 9 |
| 4. | Aktivet afatgjata jo-materiale | 10 |
| 5. | Mjete monetare | 10 |
| 6. | Inventari | 10 |
| 7. | Kliente dhe te tjera kerkesa te arketueshme | 11 |
| 8. | Detyriml per tatim fitimin | 11 |
| 9. | Furnitore dhe detyrime te tjera | 11 |
| 10. | Provizion per shpenzime | 12 |
| 11. | Te ardhurat nga shitja e mallrave | 12 |
| 12. | kosto e mallrave te shitura | 12 |
| 13. | Shpenzime per punonjesit | 12 |
| 14. | Shpenzime te pergjithshme administrative | 13 |
| 15. | Shpenzime te tjera | 13 |
| 16. | Fitim/(Humbje) nga kembimet valutore | 13 |
| 17. | Tatim fitimi | 14 |
| 18. | Ngjarje te tjera pas dates bilancit | 14 |

BAKER TILLY
ALBANIA

Rr.Themistokli Germenji, Nr.2
Pall.Ambasador 1, 3-rd floor
Tirana
Albania

T: +355(0)42232726

office@bakertillyalbania.com
www.bakertillyalbania.com

# RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

## Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të LC WAIKIKI Retail AL Sh.p.k, që përfshijnë pasqyrën e gjëndjes financiare më 31 Dhjetor 2014, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë si dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabile dhe shënime të tjera shpjeguese.

## Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi i Shoqërisë është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Kjo përgjegjësi përfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brëndshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrime apo pasaktësira; përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të duhura kontabël dhe bërjen e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme për rrethanat.

## Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tonë. Ne kryem auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarte kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin me qëllim që të përftojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë gabime materiale.

Auditimi përfshin proçedura për të marrë evidencë auditimi për vlerat dhe paraqitjet në pasqyrat financiare. Proçedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë dhe vlerësimin e riskut të egzistencës së gabimeve materiale në pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktësira. Në bërjen e këtyre vlerësimeve, audituesi konsideron kontrollin e brëndshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brëndshëm të shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e parimeve kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të arsyeshme për dhënien e opinionit të auditimit.

**Opinion**

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të LC WAIKIKI Retail AL Sh.p.k. paraqesin në mënyrë të sinqertë në të gjitha aspektet materiale gjëndjen financiare të shoqërisë më 31 Dhjetor 2014, rezultatin financiar dhe flukset monetare për vitin e mbyllur në këtë datë në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit miratuar me Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

BAKER TILLY ALBANIA
SHPK
K91721010Q

Baker Tilly Albania shpk.

Elton Haxhi
Ekspert Kontabel i Regjistruar

Tiranë
19 Qershor 2015

## PASQYRA E GJENDJES FINANCIARE

*(Gjithe vlerat ne Leke)*

| | Shenime | 31 Dhjetor 2014 | 2013 |
|---|---|---|---|
| **AKTIVI** | | | |
| Aktive afatgjata materiale | 3 | 270.837.612 | 191.972.402 |
| Aktive afatgjata jo-materiale | 4 | 3.611.516 | 3.012.917 |
| **Totali i aktiveve afatgjate** | | **274.449.128** | **194.985.319** |
| Mjete monetare | 5 | 275.491.760 | 115.622.918 |
| Inventari | 6 | 168.340.371 | 126.780.534 |
| Kliente dhe te tjera kerkesa te arketueshme | 7 | 4.877.649 | 1.419.640 |
| **Totali i aktiveve afatshkurter** | | **448.709.780** | **243.823.091** |
| **TOTALI I AKTIVEVE** | | **723.158.908** | **438.808.410** |
| **KAPITALI DHE DETYRIMET** | | | |
| Kapitali i nenshkruar | | 50.000.000 | 50.000.000 |
| Fitime te mbartura | | 577.348.230 | 313.570.990 |
| Rezerva ligjore | | 5.000.000 | 5.000.000 |
| **Kapitalet e veta** | | **632.348.230** | **368.570.990** |
| Furnitore dhe detyrime te tjera | 9 | 69.268.219 | 60.768.380 |
| Detyrime per tatim fitimi | 8 | 18.459.576 | 8.369.054 |
| Provizione per shpenzime | 10 | 3.082.883 | 1.099.986 |
| **Total i detyrimeve afatshkurter** | | **90.810.678** | **70.237.420** |
| **TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE** | | **723.158.908** | **438.808.410** |

Pasqyrat financiare dhe shenimet shpjeguese nga faqja 1 deri 14 jane firmosur dhe miratuar me 26 Mars 2015 nga:

**ADMINISTRATOR**
**Harun Demirtas**

**Shefe Finance**
**Majlinda Risilia**

Adresa : Autostrada Tr - Dr Km.8 City Park Kati 2 Tirane Albania
LC WAIKIKI RETAIL AL Sh. p. k. NUIS L 01508008 R

Adresa : Autostrada Tr - Dr Km.8 City Park Kati 2 Tirane Albania
LC WAIKIKI RETAIL AL Sh. p. k. NUIS L 01508008 R

## PASQYRA E TE ARDHURAVE

*(Gjithe vlerat ne Leke)*

| | | Viti i mbyllur 31 Dhjetor | |
|---|---|---|---|
| | Shenime | 2014 | 2013 |
| Te ardhura nga shitjet | 11 | 1.343.576.384 | 896.463.150 |
| Kosto e mallrave te shitur | 12 | (717.055.505) | (490.635.142) |
| **Fitimi bruto** | | **626.520.879** | **405.828.008** |
| Shpenzime per punonjesit | 13 | 80.283.610 | 56.478.332 |
| Shpenzime te pergjithshme dhe administrative | 14 | 196.840.573 | 137.901.246 |
| Shpenzime te tjera | 15 | 10.481.394 | 6.115.991 |
| Provizione per shpenzime | 10 | 1.982.897 | - |
| Amortizimi | 3,4 | 18.606.217 | 15.234.449 |
| **Totali i shpenzimeve te aktivitetit** | | **308.194.691** | **215.730.018** |
| Rimarrje provizionesh | 10 | - | 131.009 |
| Te ardhura/(shpenzime) te tjera | | 179.890 | 223.206 |
| **Fitimi nga aktiviteti kryesor** | | **318.506.078** | **190.452.205** |
| Fitime/(humbje) financiare | | (2.497.417) | |
| Fitime/(humbje) nga konvertimi | 16 | (4.150.394) | (2.135.893) |
| **Totali i shpenzimeve financiare** | | **(6.647.811)** | **(2.135.893)** |
| **Fitimi perpara tatimit** | | **311.858.267** | **188.316.312** |
| Tatim fitimi | 17 | (48.081.027) | (19.430.129) |
| **Fitimi neto i vitit ushtrimor** | | **263.777.240** | **168.886.183** |

# PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVE MONETARE

*(Gjithe vlerat ne Leke)*

| | Shenime | Viti i mbyllur 31 Dhjetor | |
|---|---|---|---|
| | | | 2013 |
| Fitime/(humbje) perpara tatimit | | 311.858.267 | 188.316.313 |
| *Korrigjime per:* | | | |
| Amortizimi | 3,4 | 18.606.217 | 15.234.449 |
| Rritje/ (ulje) ne provizione per kthimet e shitjeve | 10 | 1.982.897 | (131.009) |
| Shpenzime te perllogaritura | | 0 | 2.761.848 |
| **Fitimi nga aktiviteti perpara ndryshimeve ne kapitalin punues** | | ***332,447,381*** | ***206.181.601*** |
| (Rritje)/ulje ne inventar | | (41.559.837) | (44.897.485) |
| (Rritje)/ulje ne kliente dhe te tjera kerkesa per arketim | | (3.458.010) | 2.652.947 |
| Rritje/(ulje) ne furnitore dhe detyrimet e tjera | | 8,499,839 | (36.633.270) |
| *Fluksi i parase nga aktiviteti kryesor* | | *295.929.371* | *127.303.793* |
| Tatim fitimi i paguar | 9 | (37.990.505) | (10.685.868) |
| **Fluksi neto i parase nga aktiviteti kryesor** | | **257.938.867** | **116.617.925** |
| | | | |
| **Fluksi nga aktiviteti investues** | | | |
| Blerje aktive afatgjata materiale | | (98.070.024) | (8.145.340) |
| Parapagime per punime ne proces | | - | (51.104.622) |
| **Fluksi neto nga investimet** | | **(98.070.024)** | **(59.249.962)** |
| | | | |
| **Fluksi nga aktiviteti financues** | | | |
| Kapitali aksioner | | - | - |
| **Fluksi neto nga financimet** | | - | - |
| | | | |
| **Rritja/(pakesimi) neto ne mjete monetare** | | 159.868.842 | 57.367.963 |
| Mjete monetare ne 1 Janar | 4 | 115.622.918 | 58.254.955 |
| **Mjete monetare ne 31 Dhjetor** | 4 | **275.491.760** | **115.622.918** |

# PASQYRA E LEVIZJEVE NE KAPITAL

*(Gjithe vlerat ne Leke)*

| | Kapitali i nenshkruar | Rezerva Ligjore | Fitime te mbartura | Totali |
|---|---|---|---|---|
| **Gjendje ne 31 Dhjetor 2011** | 50.000.000 | 968.983 | 63.309.751 | **114.278.734** |
| Rezerva ligjore nga fitimi 2011 | - | 2.244.954 | (2.244.954) | - |
| Fitimi i vitit 2012 | - | - | 85.406.073 | **85.406.073** |
| **Gjendje ne 31 Dhjetor 2012** | 50.000.000 | 3.213.937 | 146.470.870 | **199.684.807** |
| Rezerva ligjore nga fitimi 2012 | - | 1.786.063 | (1.786.063) | - |
| Fitimi i vitit 2013 | - | - | 168.886.183 | **168.886.183** |
| **Gjendje ne 31 Dhjetor 2013** | **50.000.000** | **5.000.000** | **313.570.990** | **368.570.990** |
| Fitimi i vitit 2014 | - | - | 263,777,240 | **263,777,240** |
| **Gjendje ne 31 Dhjetor 2014** | **50.000.000** | **5.000.000** | **577,348,230** | **632,348,230** |

## 1. INFORMACION I PERGJITHSHEM

Shoqeria Tema Retail AL Shpk. (me poshte "Shoqeria") eshte krijuar si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne date 05/03/2010. Me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Aksionereve numer 178, date 26 qershor 2014, depozituar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit me numer CN-651660-09-14, emertimi i shoqerise u ndryshua ne LC WAIKIKI Retail AL Sh.p.k.

Objekti kryesor i veprimtarise se shoqerise perfshin tregtimin, import-eksport dhe shitje me pakice e shumice te mallrave, sipermarrje dhe sherbime ne fusha te ndryshme. Shitje me shumice e pakice e tekstileve, veshjeve, veshjeve sportive, kepuceve dhe artikujve te lekures neper panaire, stenda e dyqane te specializuara.

Kapitali i nenshkruar dhe struktura aksionare me 31 Dhjetor 2014 dhe 2013 paraqiten si me poshte:

| | 31 Dhjetor 2014 | | 31 Dhjetor 2013 | |
|---|---|---|---|---|
| | **Ne %** | **Ne Vlere** | **Ne %** | **Ne Vlere** |
| LC Waikiki Magazacilik Hizmetleri Ticaret AS | 100% | 50.000.000 | 100% | 50.000.000 |
| | **100%** | **50.000.000** | **100%** | **50.000.000** |

Me 31 Dhjetor 2014 shoqeria kishte 113 te punesuar (31 Dhjetor 2013 : 79 punonjes). Adresa e shoqerise eshte Njesia Bashkiake Nr. 10, Sheshi Skenderbe, Pallati i Kultures, Tirane. Shoqeria eshte regjistruar si tatimpagues ne rrethin e Tiranes me NIPT L01508008R.

Pasqyrat financiare te shoqerise per ushtrimin e mbyllur me 31 Dhjetor 2014 jane miratuar nga Administratori i shoqerise me 26 mars 2015.

## 2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE

### a. Bazat e pergatitjes se pasqyrave financiare

Paqyrat financiare jane pergatitur, ne te gjithe aspektet materiale, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), te cilat perbehen nga regullat dhe interpretimet ne perputhje me Ligjin nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrat financiare jane pergatitur mbi bazen e kostos historike. Te dhenat aktuale dhe krahasuese jane prezantuar ne Lek Shqiptare (LEK), qe eshte monedha raportuese e shoqerise.

### b. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

*(i).Njohja dhe matja*

Te gjitha aktivet afat-gjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, çdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes si ne gjendjen e meparshme te vendndodhjes se aktivit. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivit kur perfundon ndertimi tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise.

Ne rastet kur pjese te nje aktivi afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afat-gjata materiale.

## 2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE (VAZHDIM)

### b. Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur, dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave.

*(ii)Kostot e mepasshme*

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afat-gjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

*(iii) Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden lineare apo zbritese te amortizimit, mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivit afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivit. Toka nuk amortizohet.

Norma e amortizimit per periudhen aktuale jane si me poshte:

| Kategoria | Metoda e amortizimit | Norma e amortizimit |
|---|---|---|
| Instalime teknike | Mbi vleren kontabel neto | 5% |
| Mobilje dhe paisje zyre | Mbi vleren kontabel neto | 20% |
| Pajisje informatike | Mbi vleren kontabel neto | 25% |
| Licenca dhe programe kompjuterike | Metoda lineare | 15% |

Aktivet afatgjata jomateriale njihen atehere kur eshte e mundur qe perfitime ekonomike do te sigurohen ne te ardhmen ne lidhje me keto aktive dhe kostoja e tyre mund te matet ne menyre te besueshme.

### c. Inventari

Inventaret jane paraqitur ne pasqyrat financiare te Shoqerise duke perdorur vleren e blerjes se tyre qe eshte me e vogel se vlera neto e realizueshme. Per inventarizim shoqeria ka perdorur metoden periodike dhe per vleresimin ka perdorur metoden e kostos mesatare te ponderuar.

### d. Llogarite e arketueshme dhe llogari te pagueshme

Llogarite e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provizioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshtiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe llogarite e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen efektive te interesit.

Llogarite e pagueshme paraqiten me vleren e tyre te drejte dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

## 2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE (VAZHDIM)

### e. Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne te pare me bankat ne Lek dhe ne monedha te huaja. Per qellimin e pasqyres se flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj perfshijne depozita pa afat ose me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

### f. Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale dhe regjistrohen me kursin e kembimit ne daten e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare ne monedhe te huaj ne daten e raportimit konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit ne daten e bilancit.

Fitimi ose humbja nga kembimi ne zera monetare eshte diferenca qe vjen nga kembimi i nje numri te caktuar njesish te nje monedhe te huaj ne monedhen funksionale me kurse te ndryshme kembimi ne datat e kembimit. Te drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet ne lidhje me AAM per t'u blere ne monedhe te huaj konvertohen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates se kryerjes se transaksionit ndersa ato qe maten me vlere te drejte rikembehen ne monedhen funksionale me kursin e kembimit te dates kur eshte percaktuar vlera e drejte. Diferencat qe rezultojne nga kursi i kembimit kalojne ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare te kembimit per monedhat kryesore te perdorura ne konvertimin e zerave te bilancit ne monedhe te huaj ishin si me poshte (ne Lek):

| | 31 Dhjetor 2014 | 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| 1 EUR | 140,14 | 140,20 |
| 1 USD | 115,23 | 101,86 |

### f. Njohja e te ardhurave

Te ardhurat njihen ne masen qe eshte e mundshme qe perfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijne kompanise dhe keto perfitime mund te maten ne menyre te besueshme. Shpenzimet njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Te ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen ne pasqyrat financiare te periudhes te ciles i perkasin.

### g. Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin eshte llogaritur ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per tatimin mbi fitimin per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2014. Tatimi mbi fitimin perfshin teresisht tatimin mbi fitimin e llogaritur per periudhen kontabel. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 15% e fitimit te tatueshem te percaktuar ne legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor ne Shqiperi per vitin 2014 (2013: 10%).

### h. Fondet per pensione

Shoqeria paguan kontributet per pensione si edhe kontribute per sigurim shendetsor per punonjesit e saj sic eshte parashikuar nga legjislacioni social vendas. Kontributet, bazuar ne pagat, jane paguar ne llogari te organizmave kombetare pergjegjes per pagesen e pensioneve dhe shpenzimeve shendetsore. Nuk ka asnje detyrim tjeter ne lidhje me fondin per pensione dhe shpenzime shendesore.

## 2. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE TE RENDESISHME KONTABILE (VAZHDIM)

### i. Krahasueshmeria

Informacioni krahasues paraqitet ne menyre te vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabel te Shoqerise dhe duke u bazuar ne modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kontabel Shqiptar.

### j. Biznesi ne vijimesi

Te dhenat e kontabilitetit jane mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhes, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

Pasqyrat financiare jane pergatitur sipas parimit te vijimesise, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjate ecurise normale te biznesit.

## 3. AKTIVET AFATGJATE MATERIALE

| | Instalime Teknike | Mobilje dhe Pajisje Zyre | Pajisje Informative | Te tjera | Ne proces | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kosto** | | | | | | |
| **Me 31 Dhjetor 2012** | **108.484.106** | **61.303.108** | **7.632.784** | **23.908** | - | **177.443.906** |
| Shtesa | 4.573.869 | 178.955 | 2.875.094 | 42.470 | 51.104.622 | **58.775.010** |
| **Me 31 Dhjetor 2013** | **113.057.975** | **61.482.063** | **10.507.878** | **66.378** | **51.104.622** | **236.218.916** |
| Shtesa | 84.221.236 | 513.792 | 11.729.391 | 70.863 | - | 96.535.282 |
| Ri-klasifikim | 51.104.622 | - | - | - | (51.104.622) | - |
| **Me 31 Dhjetor 2014** | **248.383.833** | **61.995.855** | **22.237.269** | **137.241** | - | **332.754.198** |
| **Amortizimi i akumuluar** | | | | | | |
| **Me 31 Dhjetor 2012** | **(4.720.483)** | **(22.586.960)** | **(2.632.199)** | **(2.789)** | - | **(29.942.431)** |
| Amortizimi per vitin | (5.206.440) | (7.746.212) | (1.345.403) | (6.027) | - | (14.304.082) |
| **Me 31 Dhjetor 2013** | **(9.926.923)** | **(30.333.172)** | **(3.977.601)** | **(8.816)** | - | **(44.246.513)** |
| Amortizimi per vitin | (8.461.538) | (6.266.450) | (2.924.736) | (17.349) | - | (17.670.073) |
| **Me 31 Dhjetor 2013** | **(18.388.461)** | **(36.599.622)** | **(6.902.338)** | **(26.165)** | - | **(61.916.586)** |
| **Vlera kontabel neto** | | | | | | |
| **Me 31 Dhjetor 2012** | **103.763.623** | **38.716.148** | **5.000.585** | **21.119** | - | **147.501.475** |
| **Me 31 Dhjetor 2013** | **103.131.052** | **31.148.891** | **6.530.277** | **57.562** | **51.104.622** | **191.972.403** |
| **Me 31 Dhjetor 2014** | **229.995.372** | **25.396.233** | **15.334.931** | **111.076** | - | **270.837.612** |

Balancat e hapjes me 1 janar 2013 jane risklasifikuar per te paraqitur ne menyre te drejte klasifikimin dhe ndarjen e aktiveve afatgjata materiale nga ato jo-materiale.

## 4. AKTIVET AFATGJATA JO-MATERIALE

| | Licenca | Programe kompjuterike | Total |
|---|---|---|---|
| **Kosto** | | | |
| **Me 31 Dhjetor 2012** | 208.699 | 4.627.188 | **4.835.887** |
| Shtesa | 474.951 | - | 474.951 |
| **Me 31 Dhjetor 2013** | **683.649** | **4.627.188** | **5.310.837** |
| Shtesa | 1.043.771 | 490.971 | 1.534.742 |
| **Me 31 Dhjetor 2014** | **1.727.420** | **5.118.159** | **6.845.579** |
| | | | |
| **Amortizimi i akumuluar** | | | |
| **Me 31 Dhjetor 2012** | **(102.403)** | **(1.265.149)** | **(1.367.552)** |
| Amortizimi per vitin | (89.859) | (840.510) | (930.368) |
| **Me 31 Dhjetor 2013** | **(192.261)** | **(2.105.659)** | **(2.297.920)** |
| Amortizimi per vitin | (174.557) | (761.587) | (936.143) |
| **Me 31 Dhjetor 2014** | **(366.818)** | **(2.867.245)** | **(3.234.064)** |
| | | | |
| **Vlera kontabel neto** | | | |
| **Me 31 Dhjetor 2012** | **106.296** | **3.362.039** | **3.468.335** |
| **Me 31 Dhjetor 2013** | **491.388** | **2.521.529** | **3.012.917** |
| **Me 31 Dhjetor 2014** | **1.360.602** | **2.250.914** | **3.611.516** |

## 5. MJETE MONETARE

| | 31 Dhjetor 2014 | 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Arka | 16.178.348 | 10.637.129 |
| Banka | 258.615.938 | 103.245.893 |
| Karte Krediti | 697.473 | 1.739.896 |
| | **275.491.760** | **115.622.918** |

## 6. INVENTARI

| | 31 Dhjetor 2014 | 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Mallra per shitje | 168.340.371 | 125.173.943 |
| Inventar i imet | - | 1.606.591 |
| | **168.340.371** | **126.780.534** |

## INVENTARI I MJETEVE TE TRANSPORTIT NE PRONESI

| | 31 Dhjetor 2014 | 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Mjete Transporti | NUK KA | NUK KA |

## 7. KLIENTE DHE TE TJERA KERKESA TE ARKETUESHME

| | 31 Dhjetor 2014 | 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Shpenzime te periudhave te ardhshme | 948.170 | 1.268.331 |
| Parapagime | 3.064.121 | - |
| Te tjera kerkesa | 865.358 | 151.309 |
| | **4.877.649** | **1.419.640** |

## 8. DETYRIMI PER TATIM FITIMIN

| | 31 Dhjetor 2014 | 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Gjendje ne 1 Janar | (8.369.054) | 375.207 |
| Tatim fitimi i paguar gjate vitit | 37.990.505 | 10.685.868 |
| Tatim fitimi i vitit ushtrimor | (48.081.027) | (19.430.129) |
| **Detyrimi i tatim fitimit** | **(18.459.576)** | **(8.369.054)** |

## 9. FURNITORE DHE DETYRIME TE TJERA

| | 31 Dhjetor 2014 | 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Furnitore | 56.421.702 | 50.937.867 |
| Shpenzime te perllogaritura | 4.992.520 | 4.933.147 |
| TVSH e pagueshme | 3.922.229 | 1.617.986 |
| Paga dhe shperblime | 1.600.495 | 1.309.166 |
| TVSH per t'u sistemuar | 271.905 | 191.741 |
| Sigurime shoqerore dhe shendetesore | 1.580.333 | 1.260.730 |
| Tatim mbi te ardhurat personale | 479.035 | 517.742 |
| | **69.268.219** | **60.768.380** |

### TVSH e pagueshme

| | 31 Dhjetor 2014 | 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| TVSH e llogaritur | 269.810.924 | 177.001.338 |
| TVSH i zbritshem blerje brenda vendit | (46.542.710) | (33.364.356) |
| TVSH i zbritshem blerje import | (156.707.554) | (110.235.733) |
| **TVSH per tu paguar** | 66.560.670 | 33.401.249 |
| | | |
| TVSH e pagueshme nga viti 2013 | 1.617.986 | - |
| TVSH e paguar gjate vitit | (64.256.417) | (31.783.263) |
| **Detyrime tatimore per TVSH-ne ne 31 Dhjetor 2014** | **3.922.229** | **1.617.986** |

Ne shifren e afarizimit dhe TVSH-ne e llogaritur ne blerje dhe shitje sipas sistemit tatimor eshte perfshire edhe vlera e tatueshme 4.756.916 Lek (2012 : Lek 6.810.331) per autofaturimet sipas nenit 15, pika 5 te ligjit 7928 per "Tatimin mbi Vleren e Shtuar" e cila nuk perfaqeson nje te ardhur per shoqerine.

## 10. PROVIZION PER SHPENZIME

| | 31 Dhjetor 2014 | 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Ne 1 Janar | 1.099.986 | 1.230.995 |
| - Shtesa per ceshtje tatimore | 1.541.928 | - |
| Shtesa per kthimin e shitjeve | 440.969 | (131.009) |
| **Ne 31 Dhjetor** | **3.082.883** | **1.099.986** |

Provizionet per kthimin e shitjeve perfaqesojne parashikimet e drejtimit per kthim e mallrave te shitura ne perputhje me politiken e shitjeve te Shoqerise. Ndersa provizionet per ceshtjet tatimore konsistojne ne shumat e detyrimeve shtese dhe gjobave qe Shoqeria do te duhet te paguaje sipas raport kontrollit tatimor nr. 82857/4 date 5 mars 2015 te leshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tirane.

## 11. TE ARDHURAT NGA SHITJA E MALLRAVE

Te ardhurat nga shitja e mallrave per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014 jane 1.343.756.384 Leke (2013: 896.463.150 Leke).

## 12. KOSTO E MALLRAVE TE SHITURA

Kosto e mallrave te shitura per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2014eshte 717.055.505 Leke (2013: 490.635.142 Leke).

## 13. SHPENZIME PER PUNONJESIT

| | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2014 | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Paga dhe shperblime | 68.684.986 | 48.258.917 |
| Sigurime shoqerore dhe shendetesore | 9.508.860 | 6.327.591 |
| Personel i perkohshem | 2.089.764 | 1.891.824 |
| | **80.283.610** | **56.478.332** |

## 14. SHPENZIME TE PERGJITHSHME ADMINISTRATIVE

| | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2014 | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Qira | 95.573.154 | 62.499.497 |
| Tarife Sherbimi nga Qendrat Tregetare | 23.748.405 | 20.991.894 |
| Shpenzime te tjera operative | 21.459.436 | 20.026.272 |
| Ambalazh dhe inventar i imet | 17.731.096 | 9.960.228 |
| Shpenzimi marketingu dhe reklama | 15.481.300 | 6.504.977 |
| Energji, uje | 13.290.810 | 8.004.582 |
| Sherbime profesionale | 7.681.211 | 8.390.374 |
| Shpenzime postare dhe telekomunikimi | 1.059.271 | 845.573 |
| Transferime, udhetime dhe dieta | 815.890 | 677.849 |
| | **196.840.573** | **137.901.246** |

## 15. SHPENZIME TE TJERA

| | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2014 | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Humbje nga inventari fizik | 4.729.706 | 3.456.191 |
| Shpenzime te tjera | 5.751.688 | 2.659.800 |
| | **10.481.394** | **6.115.991** |

## 16. FITIM/(HUMBJE) NGA KEMBIMET VALUTORE

| | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2014 | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| Fitime nga kembimet valutore | 2.100.283 | 6.037.854 |
| Humbje nga kembimet valutore | (6.250.677) | (8.173.747) |
| | **(4.150.394)** | **(2.135.893)** |

## 17. TATIM FITIMI

| | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2014 | Viti i mbyllur 31 Dhjetor 2013 |
|---|---|---|
| **Fitimi para tatimit** | **311.858.267** | **188.316.312** |
| Ulje e provizionit per kthimet e shitjeve | - | (131.009) |
| *Shpenzime te panjohura* | *8.681.913* | *6.115.992* |
| Shpenzime ne dogane | | 72.445 |
| Sherbime taksi | 194.850 | 203.500 |
| Shpenzime te tjera personeli | 668.712 | |
| Karburant | 125.102 | 29.660 |
| Provizione per shpenzime | 440.969 | - |
| Penalitete tatimore | 1.849.442 | 500.000 |
| Udhetime dhe dieta | 920.717 | 817.786 |
| Shpenzime perfaqesimi | 1.254.301 | 307.238 |
| Humbje nga inventari | 1.631.428 | 3.456.190 |
| Te tjera | 2.265.104 | 729.172 |
| Shpenzime pritje percjellje | 278.616 | |
| **Fitimi i tatueshem** | **320.540.180** | **194.301.295** |
| **Tatim Fitimi 15% (2013: 10%)** | **48.081.027** | **19.430.129** |

## 18. NGJARJE TE TJERA PAS DATES BILANCIT

Nuk ka asnje ngjarje te rendesishme pas mbylljes se vitit ushtrimor qe te kerkoje korrigjime apo pershkrime ne keto pasqyra financiare pervec atyre te paraqitura ne shenimet e ketyre pasqyrave financiare.